



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:107639
Datë: 25.06.2024
Numri i dokumentit: 05857900

K.Dh.Sh II.nr.431/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me numër fiskal 600215364 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Pashko Vasa”, nr. 12, Lagjia Pejton, kundër debitorit “City Posta” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810875099 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Shaban Polluzha”, nr.27, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.771/23 të datës 12.12.2023, me datë 25.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e kreditorit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 771/23 të datës 12.12.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 771/23 të datës 12.12.2023, në pikën dispozitiv e ka pranuar në tërësi si

të bazuar prapësimin e debitorit “City Posta” Sh.P.K të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbarrim P.nr. 539/23, të dt. 20.04.2023, të Përmbarruesit Privat Isa Gacaferri dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim në është Anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve thelbësore të dipozitive të procedurës kontestimore dhe përmbarrimor, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 771/23 të datës 12.12.2023, dhe të detyrohet debitori të bëjë pagesën e borxhit sipas faturave.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me datën 20.04.2023, ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, dokumentit të besueshëm – Faturës Nr. 0451-2020 e datës 09.10.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që të ia paguaj kreditorit borxhin në shumë prej 500.00 €, me kamatë ligjore prej 8 %, duke filluar nga data kur kërkesa është bërë e arritshme e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit. Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor duke theksuar se lidhur me borxhin që pretendon kreditori për shumën prej 500.00 € nuk është e saktë, sepse në kohën kur kreditori ka kërkuar sqarim lidhur me porosinë ka qenë pandemia, dhe debitori nuk ka punuar me shërbime online apo në formë elektronike. Duke qenë se vlerat janë të ndryshme në faturë dhe në urdhrin përmbarrimor ka kërkuar nga kreditori që rishqyrtoj marrëveshjen në mes të kreditorit dhe debitorit sepse asnjëherë nuk kanë

pasur mosmarrëveshje rreth porosive. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar, ashtu që urdhri përmbartimor të anulohet. Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit si të pabazuar duke deklaruar se kjo lëndë nuk ka të bëjë me shqiptimin e gjobës për porosi online, por lidhur me mos dorëzimin e pasqyrave të audituara financiare për vitin 2019. Ka shtuar se pretendimi i debitorit se janë dhënë vlera të ndryshme nga urdhri përmbartimor dhe nga faturat nuk qëndron, sepse edhe nga vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të gjendjes emergjente të shëndetit publik, me qëllim të vazhdimit të ofrimit të shërbimeve dhe krijimit të kushteve sa më të sigurta për stafin e ARKEP dhe palët, i njëjti i ka njoftuar të gjithë operatorët se do të shtyhet afati për dorëzimin e pasqyrave financiare për vitin 2019 deri me datë 30 prill 2020, dhe këto raporte nga operatorët duhet të dërgohen vetëm në formën elektronike, ku i njëjti përmes postës elektronike ka ftuar operatorët që në përmbushje të obligimeve ligjore të paraparë me nenin 55 të Ligjit për shërbimet postare dhe konform konkluzionit të Bordit të ARKEP, që në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të dërgojnë “pasqyrat financiare vjetore të audituara për vitin 2019”. Ka shtuar se përkundër këtij afati shtesë debitori nuk ka dërguar raportin e audituar financiar, andaj ARKEP me datë 09 tetor 2020 ka dërguar tek debitori vendimin nr. 1626 për shqiptimin e gjobës ndaj ndërmarrjes “City Posta” Sh.P.K dhe faturat nr. 0451-2020 dhe 0453-2020 të datës 10.09.2020. Nga të lartcekurat, i ka propozuar gjykatës që urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet me arsyetim se sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.” Po ashtu ka shtuar se fatura 0451-2020 e datës 09.10.2020 në bazë të së cilës është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm

sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin apo vulën e biznesit të debitorit, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë provë tjetër përmes të cilës do mund të vërtetohet se fatura është dorëzuar me rregull dhe është pranuar nga ana e debitorit. Po ashtu dhoma e shkallës së parë pati parasysh faktin se në shkresat e lëndës kreditori ka bashkangjitur komunikimin elektronik të datës 10.09.2020, përmes të cilit komunikim i ka dorëzuar debitorit faturën nr. 0451- 2020, por që në mungesë të një konfirmimi nga ana e debitorit se ka pranuar faturën e lartcekur dhe atë duke mos kundërshtuar detyrimin që buron nga kjo faturë, andaj Gjykata nuk mund ta pranoj si të rregullt këtë formë të dorëzimit të faturës.

Dhoma e Shkallës së Dytë e vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përbarimore nr.04/L-139, përcaktohet se përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që e njëjta nuk është nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përbarimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Kështu Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se Fatura 0451-2020 e datës 09.10.2020 në bazë të së cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas nenit 29.3 të LPP-së, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, duke qenë se fatura nuk përmban nënshkrimin apo

vulën e biznesit të debitorit, edhe pse kreditori ka bashkangjitur komunikimin elektronik të datës 10.09.2020, përmes të cilit komunikim i ka dorëzuar debitorit faturën nr. 0451- 2020, por që nuk është e konfirmuar nga ana e debitorit se ka pranuar faturën e lartcekur.

Dhomat e Shkallës së Dytë pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përbarimit P.nr.539/2023 i datës 20.04.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase dokumenti i besueshëm-fatura nuk i ka tiparet e përbarushmërisë ashtu sipas dispozitave të lartë cekura.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet e debitorit në ankesë lidhur me at se për shkak së ka qenë koha e pandemis-Covid-19 nuk ka mundur ti dorëzoj fizikisht faturën debitorit por e ka dërguar përmesë e-mail-it, por një pretendim të tillë e refuzoj si të pabazuar për shkak se fatura me nr.0451-2020 e ka datën 09.10.2020 që kuptohet se në atë kohë masat lidhur me pandemin kanë ndryshuar ngase të gjitha institucionet publike kanë punuar me masa mbrojtës si dhe me staf të reduktuar dhe se nuk ka qenë penges për pranimin apo dorëzimin e shkresave nëpër institucione. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturave nga ana e debitorit, Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase sipas dispozitave të lartcekura fatura duhet të jenë të nënshkruara. Në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit si dhe në shkresa të lëndës nuk mund të konfirmohet se debitori përmesë e-mail-it ka pranuar faturën në fjalë, andaj si e tillë nuk mund të pranohet si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përbarimore, mirëpo kreditori mund të inicoj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij, varësisht nga suksesi nga ajo procedurë. Nga të cekurat më lartë kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Kështu Dhoma e shkallës së dytë është e qëndrimit se në procedurën përbarimore organi përbarues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përbarimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e raportit juridik nga i cili rrjedh dokumenti i besueshëm, statusin e palëve apo detyrimet e ndërsjella mes tyre. Por, organi përbarues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e

dokumentit përmbaues dhe/apo atij të besueshëm, me ç'rast procedura sipas prapësimit i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh.II.nr.431/24, me datë 25.06.2024

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija Ymeri